



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 389/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.09.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të ofertës teknike, të paraqitur nga BOE “Gjeokonsult & Co” sh.p.k. & “Archispace” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me objekt “*Studim-Projektim “Ndërtim i Teatrit Kombëtar”*”, me nr. REF-63974-07-02-2020, me fond limit 60,317,899 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Detyrimin e autoritetit kontraktor për të vënë në dispozicion të BOE “Gjeokonsult & Co” sh.p.k. & “Archispace” sh.p.k., procesverbalin e vlerësimit të ofertave teknike, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

**Ankimues:** BOE “Gjeokonsult & Co” sh.p.k. & “Archispace” sh.p.k.  
*Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, P. nr.45, Shk. 1, K. II, Tiranë.*

**Autoriteti kontraktor:** Bashkia Tiranë  
*Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.*

**Baza Ligjore:** *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 03.07.2020, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me objekt “*Studim-Projektim “Ndërtim i Teatrit Kombëtar”*”, me nr. REF-63974-07-02-2020, me fond limit 60,317,899 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 14.07.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Në datën 13.08.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e dytë të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.4. Nga verifikimet e kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik, rezulton se në datën 20.08.2020, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertës teknike nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

II.5. Referuar parashtrimeve me shkrim të BOE ankimues “Gjeokonsult & Co” sh.p.k. & “Archispace” sh.p.k., si dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, konstatohet se ky i fundit ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor, me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të ofertës së tij teknike, si dhe kërkon vënien në dispozicion të procesverbalit të vlerësimit të ofertave

teknike për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ankim i cili referuar aktit të trajtimit të ankesës, si dhe gjurmimit të objektit postar me kod RR413241757AA, është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor në datën 28.08.2020.

II.6. Referuar materialeve të administruara, përkatësisht dokumentacionit të dorëzuar nga BOE ankimues, pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.28483/1, datë 31.08.2020, trajtim i ankesës së autoritetit kontraktor, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ngritur pranë këtij të fundit, nuk ka pranuar ankesën e ankimuesit, pasi kjo e fundit nuk është paraqitur brenda afateve ligjore pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 14.09.2020, BOE ankimues “Gjeokonsult & Co” sh.p.k. & “Archispace” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

### **III Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

#### **Arsyeton**

III.1. Në datën 03.07.2020, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me objekt “*Studim-Projektim “Ndërtim i Teatrit Kombëtar”*”, me nr. REF-63974-07-02-2020, me fond limit 60,317,899 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

III.1.1. Në datën 14.07.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

III.1.2. Në datën 13.08.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e dytë të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

III.1.3. Nga verifikimet e kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik, rezulton se në datën 20.08.2020, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertës teknike nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

III.1.4. Referuar parashtrimeve me shkrim të BOE ankimues “Gjeokonsult & Co” sh.p.k. & “Archispace” sh.p.k., si dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, konstatohet se ky i fundit ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor, me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të ofertës së tij teknike, si dhe kërkon vënien në dispozicion të procesverbalit të vlerësimit të ofertave teknike për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ankim i cili referuar aktit të trajtimit të ankesës, si dhe gjurmimit të objektit postar me kod RR413241757AA, është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor në datën 28.08.2020.

III.1.5. Referuar materialeve të administruara, përkatësisht dokumentacionit të dorëzuar nga BOE ankimues, pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.28483/1, datë 31.08.2020, trajtim i ankesës së autoritetit kontraktor, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ngritur pranë këtij të fundit, nuk ka pranuar ankesën e ankimuesit, pasi kjo e fundit nuk është paraqitur brenda afateve ligjore pranë autoritetit kontraktor.

III.1.6. Në datën 14.09.2020, BOE ankimues “Gjeokonsult & Co” sh.p.k. & “Archispace” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” *“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”.* Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”*

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, si edhe aktit mbi trajtimin e ankesës, konstatohet se ankesa e BOE ankimues “Gjeokonsult & Co” sh.p.k. & “Archispace” sh.p.k. është pranuar nga autoriteti kontraktor në datë 28.08.2020. Referuar informacionit të administruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga ana e BOE ankimues, ky i fundit ka marrë përgjigje lidhur me trajtimin e ankesës nga autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.28483/1, datë 31.08.2020. Referuar *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik të ndryshuar”, parashikohet se ankimi administrativ pranë autoritetit kontraktor dorëzohet me shkrim *brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.* Ndërsa ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzohet me shkrim *brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.* Në interpretimin gjuhësor të dispozitave të sipërcituara, afati i ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor nis nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar dhe më pas afati i ankimit administrativ pranë

Komisionit të Prokurimit Publik nis nga dita marrjes dijani mbi vendimin e KSHA-së, ose nga dita e nesërme e punës pas përfundimit të afatit kohor për kthim përgjigje nga ana e autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se BOE ankimues nuk e ka ezuaruar ankimin administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 të L.P.P.-së, pasi ankimi i dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga BOE ankimues më datë 28.08.2020, është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga *lex specialis*, pasi referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor nis nga dita e nesërme e punës kur BOE është njoftuar nga autoriteti kontraktor mbi vendimin e KVO-së dhe duhet dorëzuar pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se BOE ankimues nuk e ka ezuaruar ankimin administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 6 të L.P.P.-së, pasi ankimi i dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga operatori ekonomik ankimues më datë 14.09.2020 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga *lex specialis*, pasi referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis nga dita kur operatori ekonomik është njoftuar nga autoriteti kontraktor mbi vendimin e KSHA-së dhe duhet dorëzuar pranë KPP brenda 10 ditëve. Në këto kushte, ankesat e paraqitura prej BOE ankimues Gjeokonsult & Co” sh.p.k. & “Archispace” sh.p.k. pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik, janë pas përfundimit të afateve të parashikuara nga neni 63 pikat 2 dhe 6 të L.P.P.-së, duke mos u legjitimuar *ratione temporis* në dorëzimin e ankesës pranë K.P.P. Në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh” parashikohet se “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Sa më sipër, KPP gjykon se BOE ankimues duhet të kishte paraqitur prova fizike për të vërtetuar datën e marrjes dijani mbi aktin e trajtimit të ankesës nr.28483/1, datë 31.08.2020. KPP konstaton se nuk ka provë tjetër për tu referuar mbi marrjen dijani mbi aktin e trajtimit të ankesës nga BOE ankimues, përveç shkresës së autoritetit kontraktor mbi shqyrtimin e ankesës e cila mban datën 31.08.2020, dhe për këtë arsye përllogaritjen e afateve, KPP e bën duke filluar nga data e që mban akti i autoritetit kontraktor mbi shqyrtimin e ankesës.

III.1.9. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar nga BOE ankimues Gjeokonsult & Co” sh.p.k. & “Archispace” sh.p.k., pranë K.P.P., nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës”, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, si pasojë e mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.10. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të

shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kritereve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Gjeokonsult & Co” sh.p.k. & “Archispace” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me objekt “*Studim-Projektim “Ndërtim i Teatrit Kombëtar”*”, me nr. REF-63974-07-02-2020, me fond limit 60,317,899 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1110 Protokoli, Datë 14.09.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**